



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 22.09.2016, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Vazhdim i diskutimit rreth projektligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Vasilika Hysi, Ulsi Manja, Petrit Vasili dhe Vexhi Muçmataj

Mungojnë:

Oerd Bylykbashi, Spartak Braho, Arben Ristani, Eduard Halimi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu.

Të ftuar:

Gent Ibrahimimi – Ekspert i Nivelit të Lartë

Agnes Bernhard - Eksperte e Nivelit të Lartë

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e sotme të komisionit për shqyrtimin e projektligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen edhe një herë, meqenëse ka pasur disa ndryshime, pavarësisht se është shqyrtuar, për shkak të ndryshimeve kushtetuese dhe të ndryshimit të ligjeve të tjera kuadër që rregullojnë sistemin në bazë edhe të ligjit që kemi në proces, është e nevojshme për të parë disa ndryshime të reja.

Do të preferoja që për gjëra që janë detaje të teknikës legislative, ta ekonomizojmë kohën, meqenëse po zhvillohet seanca dhe ne jemi të detyruar të vijmë këtu për shkak të limiteve që kemi në axhendën e komisionit për efekt të realizimit të angazhimit të komisionit për ta kaluar ligjin në seancën e ardhshme.

Meqë jemi të detyruar të shkojmë në seancë e cila po vazhdon, do të doja që për ekonomi kohe të mos merremi me detajet e teknikës legislative, por vetëm me gjërat që cenojnë thelbin.

Neni 1, ka gjë?

Vasilika Hysi – Nuk ka.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Neni 2, ka gjë?

Vasilika Hysi – Për nenin 2 sugjeroj që përkufizimi i gjyqësorit ose të hiqet ose të sqarohet...

Fatmir Xhafaj - Ka gjë tjetër veç kësaj?

Vasilika Hysi – Jo.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Çfarë duhet kjo? “... sistem gjyqësor, gjykimi i pavarur dhe i paanshëm”...

Është e pakuptimtë.

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Mendoj ta fshijmë këtë përkufizim, sepse të gjithë e dinë se çfarë është një sistem gjyqësor, për këtë arsye nuk është i nevojshëm të përfshihet.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Nuk ka sens kjo. Jemi dakord me ndryshimet e propozuara për nenin 2.

Neni 3.

Vasilika Hysi – Për nenin 3 kisha vetëm një pyetje në parim: Meqenëse Kushtetuta parashikon që Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera, a mund të shtojmë një paragraf në këtë ligj, se këtu nuk thuhet që Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Atëherë, ky parim të mbahet për të gjitha nenet.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 3.

Neni 4, “Parimet e ushtrimit të pushtetit gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Jo, nuk kemi gjë, vetëm disa rregullime gramatikore.

Fatmir Xhafaj – Dakord me rregullimin që është bërë.

Neni 5, “Aksesi në gjykata”. Ka ndonjë koment.

Vasilika Hysi – Jo, është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 5.

Neni 6, “Konflikti i interesit”.

Vasilika Hysi – Jo, është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 6.

Neni 7, “Parimi i bashkëpunimit”.

Vasilika Hysi – Jo, është korrekt. Vetëm ndonjë rregullim drejtshkrimor.

Fatmir Xhafaj – Dakord me nenin 7.

Neni 8, “Parimet e shërbimit civil gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Neni 9, “Zbatimi i ligjeve të tjera”.

Vasilika Hysi – Është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Kapitulli i dytë, “Kompetencat dhe madhësia e gjykatave”; Seksioni i Parë, “Kompetencat tokësore dhe juridiksionale të gjykatave”; neni 10, “Kompetencat tokësore të Gjykatës së Lartë”.

Vasilika Hysi – Është korrekt, vetëm redaktime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 11, “Kompetencat Tokësore të Gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar”.

Vasilika Hysi – Është korrekt. Ka nevojë vetëm për redaktim.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 12, “Kompetencat tokësore të gjykatave administrative të apelit”.

Vasilika Hysi – Është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Nuk duhet thënë “gjykatave”, por duhet thënë: “Gjykatës Administrative të Apelit”, për sa kohë kemi vetëm një gjykatë në titull.

Neni 13, “Kompetencat tokësore të gjykatave”.

Vasilika Hysi –Unë propozoj këtu që titulli të bëhet “Kompetencat tokësore të gjykatave të tjera”, sepse Gjykata Administrative, Gjykata e Lartë, dhe ajo e posaçme, rregullohen. Të shtohet një paragraf në lidhje me kriteret e vlerësimit: “Në rast se nga ky vlerësim rezulton se harta gjyqësore në fuqi nuk i përmbush objektivat, parimet dhe kriteret e parashikuara në nenet 14 dhe 15 të këtij ligji, KLGJ-ja dhe ministri i Drejtësisë hartojnë një propozim të përbashkët për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”.

Gjithashtu, ka pasur një diskutim të hapur, lidhur me atë se kush do të miratojë hartën gjyqësore. Është shtuar një paragraf i pestë, riformulimin e të cilit e kanë ekspertët.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Agnes Bernhard - *(Flet përkthyesja)* Ne e ripamë materialin dhe sugjerojmë që paragrafi i pestë i këtij neni të bëhet: “Propozimi i përbashkët për hartën gjyqësore i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave nga ministri i Drejtësisë”.

Fatmir Xhafaj – Pse e vini kështu: “propozim i përbashkët”?

Të jetë: “Propozimi i KLGJ-së dhe i ministrit të Drejtësisë i dërgohet për miratim Këshillit të Ministrave”.

Agnes Bernhard - *(Flet përkthyesja)* Dakord.

Fatmir Xhafaj – Do të ketë patjetër konflikt, sepse ministri do ta mbrojë, do të diskutohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të kemi ndonjë konflikt të diskutueshëm, meqë miratohet nga KM-ja, për efekt të ndërhyrjes së ekzekutivit në gjyqësor?

Urdhëroni!

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Sipas standardeve europiane në përgatitjen e hartave gjyqësore përfshihet edhe qeveria, edhe legjislativi, kështu që kërkohet një bashkëpunim. Propozimi do të bëhet ose nga Ministria e Drejtësisë ose nga KLGJ-ja, megjithatë duhet gjithmonë të ketë bashkëpunim ndërmjet tyre. Vendimi i ekzekutivit në përgatitjen e hartave gjyqësore është i pashmangshëm, sepse kemi të bëjmë me çështje të ndarjes administrative, çështje infrastrukture. Megjithatë, duhet të ketë gjithmonë bashkëpunim. Roli i ekzekutivit është shumë i rëndësishëm në përgatitjen e hartave gjyqësore dhe ne kemi marrë parasysht kufizimet që ka Kushtetuta shqiptare në procesin e hartimit, ku KLD-ja ka një rol shumë të madh në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të cilët më pas ia dërgojnë propozimin Këshillit të Ministrave. Kështu parashikohet edhe në Kushtetutën tuaj: “Ministria e përgatit dhe ia propozon Këshillit të Ministrave”.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Ky është një model që ndiqet në Francë dhe bëhet nëpërmjet një dekreti apo një ligji që del nga qeveria.

Fatmir Xhafaj - Dakord.

Faleminderit!

Për ne është shumë e rëndësishme që ky standard të jetë një standard i pranuar nga BE-ja. Për ne nuk ka ndonjë problem, mjafton të jetë një standard i gjithëpranuar.

Dakord.

Faleminderit!

Besoj se do ta quaj të tillë, edhe nëse do të ketë një konflikt kushtetues.

Neni 13 miratohet me ndryshimet e propozuara. Neni 14.

Vasilika Hysi – Është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 15.

Vasilika Hysi – Është korrekt.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 16.

Vasilika Hysi – Është në rregull.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 17.

Vasilika Hysi – Edhe neni 17 është në rregull, i ka reflektuar të gjitha komentet tona.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 18, “Krijimi i degëve të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Këtu ka një riformulim të paragrafit të parë, lidhur me rolin që luan KLGj-ja, i cili mund të krijojë degë të gjykatës të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm ose bashkimin e degëve në juridiksionin e gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Krijimi i një dege ose bashkimi i tyre bëhet pas këshillimit me ministrin e Drejtësisë, me prokurorin e Përgjithshëm me KLP-në dhe me ministrin e Financave’.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 19.

Vasilika Hysi – Edhe neni 19 është në rregull, janë reflektuar të gjitha komentet tona.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 20.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 21, “Numri i përgjithshëm i gjyqtarëve”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 22.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime as ky nen. Vetëm në paragrafin e fundit janë shtuar fjalët: “rekomandimet e përcaktuara në raportet vjetore”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 23, “Krijimi i seksioneve dhe trupave gjykues në gjykata”.

Vasilika Hysi – Këtu ka vetëm një ndryshim të vogël. Në paragrafin e katërt, te germa “a” është shtuar: “Pas caktimit të gjyqtarëve në degë, nëse ka të tilla”.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 24, “Trupat gjykues”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 25, “Ndarja e çështjeve gjyqësore me short”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 26, “Kryetari dhe zëvendëskryetari i gjykatës”.

Vasilika Hysi – Këtu ka vetëm dy saktësime fjalësh. Në paragrafin e dytë shtohet folja: “ushtrohen”. Pra, “Në mungesë të kryetarit, kompetencat e tij ushtrohen nga zëvendëskryetari”.

Në paragrafin e tretë, fjalia të bëhet: “Zëvendëskryetari duhet të ketë të paktën pesë vjet përvojë profesionale”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këto redaktime.

Neni 27, “Përbërja e këshillave të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Vetëm janë shtuar fjalët: “në përputhje me parashikimin e pikës 5, te pika “c” e paragrafit të tretë.”

Te paragrafi i pestë janë shtuar fjalët: “sipas parashikimeve të pikave 3 dhe 4 të këtij neni”.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këto redaktime.

Neni 28, “Funksionimi i këshillit të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Vetëm ka redaktim fjalësh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fakt kemi pasur një diskutim, zoti kryetar, se cili është kuptimi. Ideja është kur nuk miraton dot një projekt-akt dhe lihet një projekt-akt tjetër, i cili do të miratohet në mbledhjen e ardhshme, pra nuk bien dakord ta miratojnë brenda asaj mbledhjeje.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 29, “Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Vetëm ka saktësime të vogla fjalësh.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 30, “Analogjia e dispozitave të tjera”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Për të mos përsëritur rregullat e organizimit të Gjykata e lartë, është si në Seksionin 1 të këtij kreu.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 31, “Seksionet dhe trupat gjykues të Gjykatës së Lartë”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 32, “Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 33, “Përbërja dhe gjykimi në kolegjet e bashkuara”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 34, “Njësia e shërbimit ligjor”.

Vasilika Hysi – Këtu ka një ndryshim. Është shtuar një paragraf i katërt: “Këshilli i Gjykatës përfshin në projektbuxhetin që paraqet në KLGJ propozimin për numrin e ndihmësmagjistratëve”.

Fatmir Xhafaj – Kisha diçka këtu: A do të ketë ndihmës të gjyqtarit dhe Njësia e shërbimit ligjor është tjetër dhe ndihmësit janë të tjerë apo nënkupton që këta janë edhe ndihmësat e gjyqtarit? Apo kjo është njësia e kërkimit, një vlerë e shtuar në gjyqtarët e Gjykatës së lartë? Ky është merak i parë që kisha.

E dyta, nëse këta konsiderohen ndihmësgjyqtarë dhe bëjnë edhe punën e gjyqtarit që quhet “njësia e shërbimit ligjor”, mund t’u themi: “të jenë magjistratë të komanduar që nënkupton që duhet të kenë Shkollën e Magjistraturës (kjo është e drejtë).

E para, mund të jetë nevoja dhe në një moment të caktuar mund të kemi nevojë që t’i plotësojmë këta. Çfarë do të bëhet?

E dyta, deri në momentin që mund të krijohen këto trupa, çfarë do të bëhet, se nuk duam të krijojmë kolaps në sistem? Kjo edhe nga pikëpamja praktike, por edhe nga nevoja që mund të kemi nesër. A mundet që të paktën gjysma e tyre të jenë magjistratë?

Urdhëroni!

Agnes Bernhard - (*Flet përthyesja*) Në ligjin për Shkollën e Magjistraturës kemi parashikuar edhe një dispozitë tranzitore, kështu që nuk do të shkarkohen që ditën e parë për të qenë të gjithë magjistratë.

Agnes Bernhard - (*Flet përthyesja*) Me kalimin e kohës, duhet të jenë të gjithë magjistratë.

Megjithatë, për ata që kanë qenë të komanduar apo të deleguar diku, parashikohet që mund të ketë mundësi për ngritje në detyrë, në mënyrë që të jetë një lloj shtyese me qëllim që të mos krijohet ky boshllëk.

Fatmir Xhafaj – A mund të parashikohet që të kemi të tjerë jo më shumë se gjysma, të kemi edhe të tjerë që s’janë magjistratë, por që janë djem dhe vajza të shkolluar, të cilët nuk duan ta bëjnë Shkollën e Magjistraturës, por që kanë cilësi të veçanta, mund të kenë përvojë, mund të jenë shkolluar jashtë për vite të tëra dhe mund të jenë shumë të mirë për kërkime. Plus kësaj, edhe nevojat, sidomos për disa gjykime specifike që kanë kolegjet e bashkuara, ka nevojë të kenë një formim shumë më të gjerë, sesa formimi i një magjistrati.

Nga kjo pikëpamje, a mund të kemi një kombinim që kur jenë mundësitë, le të jetë e gjithë njësia me magjistratë, por kur nuk janë mundësitë, të lejohet jo më shumë se gjysma.

Agnes Bernhard - (*Flet përthyesja*) Ligji e lë të hapur. Megjithatë, është edhe Qendra e Dokumentacionit apo e Dokumentimit në gjykatë, ku janë nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët mund të bëjnë kërkimet apo detyrat e tjera shtesë. Nuk dua që në këtë moment ta ndërpresim këtë që të jenë të gjithë magjistratë, sepse gjërat e tjera mund t’i mbulojnë nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët janë te Qendra e Dokumentacionit.

Fatmir Xhafaj – Gjithsesi, e lëmë të hapur këtë nen që ta diskutojmë edhe një herë me ata që kanë përvojë në praktikë për punën në gjykatë.

Jemi dakord në parim, por të shohim sa i përgjigjet realitetit, që të mos bëjmë një gjë është pozitive në thelb, por mund të na krijojë probleme në praktikë.

Neni 35, “Qendra e Dokumentacionit”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 36, “Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Janë të rakorduara me ligjin për qeverisjen?

(ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Neni 37, “Kompetencat e kryetarit të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 38, “Kompetencat e Këshillit Të Gjykatës”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Dakord.

Neni 39, “Kompetencat e Kancelarit”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Kam vetëm një sugjerim: të përdoret e njëjta terminologji si te ligji për qeverisjen. Fjalën e kam te germa “a”, e paragrafit të dytë ku thuhet: “funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, siç përcaktohet nga Këshilli i Ministrave”. Meqenëse gjatë diskutimit të ligjit për qeverisjen u la si detyrë që kjo terminologji të caktohet, të jetë në harmoni.

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë sugjerim. Germa “a”, e paragrafit të dytë mbetet për t’u harmonizuar me atë ligj.

Neni 40, “Kompetencat e mbledhjes së përgjithshme të gjyqtarëve të gjykatës”.

Vasilika Hysi – Ka një propozim për të përcaktuar sa shpesh mbledhet mbledhja e përgjithshme të gjyqtarëve. Unë sugjeroj që të mbledhet të paktën një herë në muaj, meqenëse diskuton edhe çështje të natyrës juridike, vendime unifikuese etj. Unë mendoj që paragrafi i parë të rishkruhet kështu: “Mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve mbledhet 1 herë në muaj.” Pastaj të vijojnë pikat e tjera me radhë:

“a) zgjedh një gjyqtar si zëvendës kryetar i gjykatës me shumicën e votave nga rradhët e gjyqtarëve të gjykatës;

b) diskuton dhe jep mendim për raportin vjetor të kryetarit të gjykatës;...”

Fatmir Xhafaj – Dakord me këtë sugjerim.

Neni 41, “Organizimi i Administratës Gjyqësore”.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime. Janë reflektuar diskutimet që kemi bërë në mbledhjen e mëparshme.

Fatmir Xhafaj – Ndhmësit ligjorë.

Vasilika Hysi – Flitet për ndihmësit ligjorë pranë Gjykatës së Apelit. Edhe këtu duhet bërë ndryshimi përkatës, duke pasur parasysh logjikën që thatë, zoti kryetar.

Fatmir Xhafaj – Këtu nuk janë magjistratët?

Vasilika Hysi – Kjo dispozitë është rregulluar në bazë të diskutimeve të bëra në komision.

Fatmir Xhafaj – Edhe këta janë magjistratë?

Agnes Bernhard - *(Flet përthyesja)* Këta nuk janë magjistratë, por janë nëpunës civilë gjyqësorë, të cilët trajnohen nga Shkolla e Magjistraturës dhe janë nëpunës të kualifikuar që asistojnë gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – A mund të vëmë klauzolën këtu, që ata magjistratë që bëjnë stazh, t'i bëjnë ndihmës ligjorë dhe të mos bëhen direkt gjyqtarë?

Agnes Bernhard - *(Flet përthyesja)* Jo, nuk është e mundur. Këta do të jenë nëpunës civilë gjyqësorë, të cilët do t'i nënshtrohen trajnimit fillestar nga Shkolla e Magjistraturës gjatë vitit të parë, ndërsa vitin tjetër do të trajnohen nga gjykata, si asistentë ligjorë.

Për sa i përket stazhit, ai parashikohet në ligjin për statusin, ku në vitin e tretë ata do të bëjnë stazhin dhe do të kenë një profilizim si prokurorë apo si gjyqtarë.

Agnes Bernhard - *(Flet përthyesja)* Në fillim ishte menduar që nëpunësit civilë gjyqësorë të kishin rol edhe në vendimmarrje. Megjithatë, u mendua që ishte shumë herët që t'u jepej ky rol në Shqipëri. Kështu që ata do të kualifikohen për dhënien e asistencës për gjyqtarët.

Fatmir Xhafaj – Urdhëroni, zoti Vasili!

Petrit Vasili – Unë desha të ringre një shqetësim që e kam thënë edhe në diskutimin tim, kur kemi kaluar projektligjin. Besoj se është vendi ta sqarojmë për të qenë të qartë me njëri-tjetrin. Kemi vetëm 2 figura në sistem: gjykatës dhe prokuror. Kemi përcaktuar qartë se cila është Shkolla e Magjistraturës, çfarë kualifikimi arrin etj.

Kam kërkuar (sigurisht, brenda mundësive që ka për reflektim), që ne të ruajmë një lloj terminologjie nga fillimi në mbarim. Ka gjykatës, ka gjyqtarë dhe ndihmësgjyqtarë, ka prokurorë dhe oficerë të Policisë Gjyqësore. Termi “magjistratë” që shfaqet dhe që rishfaqet, përveçse nuk sqaron gjë dhe krijon konfuzion, nuk arrin asgjë tjetër, pasi me apo pa Shkollën e Magjistraturës, këta kryejnë punën e gjyqtarit në sistem.

Shkolla e Magjistraturës është një kualifikim i shtuar, është e mirëpritur, por ne mund kemi edhe gjyqtarë, të cilët vazhdojnë karrierën akademike dhe ne nuk mund t'u themi që ndihmës një gjyqtari që mund të jetë profesor, asistent profesor apo doktor i shkencave. Sistemi njeh gjykatësit dhe prokurorët. Ne mund të themi që gjykatës do të jenë të gjithë ata që kanë mbaruar këtë edhe këtë edhe këtë.

Në sistem kemi edhe gjykatës që nuk e kanë mbaruar Shkollën e Magjistraturës, por mund të kenë titullin “Profesor” apo “Doktor”. Ata mund të jenë edhe “Doktor i shkencave” që nga pikëpamja akademike janë më lart, sesa Shkolla e Magjistraturës në sistemin tonë pasuniversitar.

Është edhe një fakt tjetër: Shkolla e Magjistraturës ka pedagogë, të cilët nuk kanë grada të kualifikimit të lartë shkencor dhe kjo nuk e lëviz thelbin e dobisë apo shkallës së lartë të përgatitjes së tyre.

Pse të mos t'i pastrojmë termat? Unë nuk them dot se neni kaq, siç e kemi edhe te përkufizimet në fillim: “ndihmësmagjistrati është gjyqtar i komanduar.” Ç'lidhje ka kjo? Për këtë ne shpjegojmë termin se çdo të thotë “gjyqtar i komanduar”, por në është apo nuk është “ndihmësmagjistrat”, e kërkon detyra që në këtë sistem që kemi ngritur, ky të jetë gjyqtar i komanduar, siç i kemi sqaruar shumë mirë edhe termat e tjera. Unë ju rilutem që ta pastrojmë në maksimum terma të tilla, që krijojnë konfuzione të kota.

Shyqyr që reforma i ka kristalizuar shumë mirë këto figura në sistem. Do t'i thosha edhe asistentes ndërkombëtare ta rishikojë këtë mundësi për ta përqendruar këtë gjë. Në një kapitull a në një sistem përkufizimesh të themi se çfarë kuptojmë me ndihmës magjistratë, çfarë kuptojmë kryesisht. Mund të sqarohen fare mirë te Shkolla e Magjistraturës, sepse ajo në fund të fundit është institucion i një kualifikimi të lartë, sido që ta rrotullojmë është sistem kualifikimi i lartë.

Po të marrim një analogji nga profesioni nga vij unë, ne kemi kardiolog, ka mbaruar në Paris, në New York apo në Tiranë, është kardiolog, është mjeku i familjes, apo infermier. Për këta e ka këtë gjë. Nuk i them dot, t'i shtojë nga mbrapa. Kush do të interesohet për kualifikime më të larta, ka bonuse më shumë, sepse ka mbaruar Shkollën e Magjistraturës, mund të arrijë një pozicion më shpejt, sesa dikush tjetër që nuk e ka, por këtu në kuptimin e ligjit e ka të qartë këtë gjë.

Do ta mbyll me një fjali: në disa raste termi “magjistratë”, “ndihmësmagjistratë” më duket si një vanitet juridik se sa një kuptim i qartë dhe i mirë juridik.

Fatmir Xhafaj – Besoj se është në vëmendjen e ekspertëve që të shikojnë për të sqaruar më mirë terminologjinë, sepse është e vërtetë që kemi konfondime fjalësh, sidomos te ligji “Për statusin”, duhet t’i shikojmë akoma më me shumë vëmendje.

Faleminderit!

Te ndihmësit ligjorë, kemi ndonjë gjë tjetër?

Vasilika Hysi – Te pika 6, zonja Agnes tha se ndihmësi ligjor nuk merret me marrjen e vendimeve, thjesht se nuk është përgatitur, ndërkohë që riformulimi që kanë sjellë në këtë pikë parashikon edhe mundësinë e marrjes së një vendimi. Paragrafi 6 lexohet: “Gjyqtari i caktuar me short e tërheq çështjen ose vendimin nga ndihmësligjori”. Ndërkohë që në paragrafin e dytë të po këtij ligji, thuhet: “Ndihmësligjori vetëm analizon praktikën, përpunon çështjen, përgatit çështje të thjeshta, kryen detyra, por nuk merr vendime”. Pra, të sqarohet edhe një herë: çfarë do të bëjnë ndihmësit ligjorë në gjykatat e Apelit, duke pasur parasysh edhe shqetësimin që sapo ngritët ju, kualitetin, çfarë lloj cilësish duhet të kenë.

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Duhet të jetë gabim në përkthim, sepse bëhet fjalë në përgatitjen e vendimit dhe jo për marrjen e tij.

Fatmir Xhafaj - Neni 42 për reflektim. Për ndryshim? Dakord.

Neni 43. “Kryesekretari”.

Vasilika Hysi - Është në rregull.

Fatmir Xhafaj - Nenin 44. “Sekretari gjyqësor”.

Vasilika Hysi - Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Neni 45. “Financimi dhe buxhetimi”.

Vasilika Hysi - Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Hiqeni këtë termin “financimi dhe buxhetimi”. Titulli është i gabuar, nuk ka lidhje me përmbajtjen e nenit.

Vasilika Hysi - Në fakt, ky është shërbimi i financës. Kanë krijuar në ligj terminologjinë “shërbimi”.

Fatmir Xhafaj – Dakord, por ndryshojeni.

Dakord me nenin 45, duke ndryshuar titullin.

Nenin 46. “Marrëdhëniet me publikun”.

Vasilika Hysi - Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Një minutë! Kemi lënë që një gjyqtar do të jetë dhe përgjegjës për marrëdhëniet me publikun, të flasë gjyqtari. Mund të ketë zëdhënës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ku i ke?

“Nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun”. Dakord. Ju kërkoj ndjesë.

Jemi dakord me nenin 46.

Neni 47. “Teknologjia e informacionit”.

Vasilika Hysi - Jemi dakord, reflekton sugjerimet që janë bërë.

Fatmir Xhafaj - Neni 48. “Arkiva gjyqësore”.

Vasilika Hysi - Ka një ndryshim, meqenëse ka një ligj, është krijuar Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit Gjyqësor që raporton te ministri i Drejtësisë dhe ka hyrë në fuqi në 1 janar, paragrafi i dytë lexohet: “Shërbimi i Arkivit Gjyqësor bashkëpunon me Arkivin Shtetëror të sistemit gjyqësor për ruajtjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit gjyqësor, i cili i nënshtrohet procedurës dhe rregullave të arkivimit të parashikuara në ligj”.

Fatmir Xhafaj - Po, saktë. Është bërë goxha punë, gjithë ai investim për të ngritur Arkivin Shtetëror të sistemit. E njëjta gjë, ndoshta duhet të replikohet dhe te prokuroria. Zoti Manja te ligji “Për prokurorinë” për arkivin duhet të replikohet e njëjta gjë, sepse ka lidhje me Arkivin Shtetëror, ta saktësojmë me ministrinë. Duhet të konsultohet kjo gjë me ministrin. Duhet ta shikojmë edhe pjesën e prokurorisë të lidhur me Arkivin Shtetëror të sistemit.

Dakord me ndryshimet.

Faleminderit!

Neni 49. Rregulli dhe siguria në gjykata.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj – Policia e Shtetit e bën këtë?

Vasilika Hysi– Po, kanë parashikuar Policinë e Shtetit. Tani është me polici private, por në ligj është parashikuar Policia e Shtetit. I vetmi shqetësim ne e kemi ngritur te ligji i Policisë së

Shtetit dhe te ligji “Për ruajtjen e subjekteve” nuk është e përcaktuar shprehimisht që gjykatat ruhen nga Policia e Shtetit, por parashikohet dhe mbrojtja nga policia private. Kjo është një vendimmarrje që duhet ta marrim ne.

Fatmir Xhafaj – Si do ta marrim ne? Ne themi po, por të gjitha kanë kosto. Policia nuk do të rrijë të merret dhe me këtë gjë.

Etilda Saliu – Ne e diskutuam me grupin e punës dhe pamë një sërë VKM-sh dhe ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe për ruajtjen e objekteve të sigurisë së veçantë. Janë rreth 4 VKM që janë të viteve 2010 dhe 2011. Objekti i gjykatës ruhet nga Policia e Shtetit brenda orarit zyrtar. Jashtë orarit zyrtar sigurohet nga vetë gjykata nëpërmjet policisë private etj. Ne gjatë diskutimeve që patëm ishte që ndoshta gjykatat gjatë gjithë orarit, për 24 orë të ruhen nga Policia e Shtetit. Megjithatë ky është sugjerimi ynë që e gjithë ruajtja të jetë e përfshirë nga Policia e Shtetit. Në rast se ju keni ndonjë sugjerim që...

Fatmir Xhafaj – Dakord. Duhet diskutuar me ta se si janë kapacitetet, mundësitë.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ky nen ka qenë më poshtë dhe ekspertët e kanë ngjitur lart. Unë nuk e gjej me vend statusin e punonjësve gjyqësorë në këtë nen, pasi i gjithë statusi i administratës, sidomos i nëpunësve civilë, është në kreun 5.

Fatmir Xhafaj – Nuk janë nëpunës civilë këta.

Vasilika Hysi – E kuptoj. Statusi i administratës është rregulluar në kreun në vijim. Ekspertët kanë sugjeruar që statusi i punonjësve gjyqësorë të rregullohet në një nen, në një kre, që nuk bën fjalë për punonjësit, por flet për probleme nga më të ndryshme, që nga arkivat, rregulli, këshilltarët. Nëse ju mendoni që ta lëmë këtu, e lëmë, nuk prish punë për ta dalluar nga kapitulli 5.

Fatmir Xhafaj – Neni 51. Kategoritë e nëpunësve civilë gjyqësorë. Në fakt këtu kanë bërë një shtesë që kanë futur njoftuesit me status nëpunësi civil. Unë kam një pyetje.

Fatmir Xhafaj – Mos e zgjasim kot.

Vasilika Hysi – Njoftuesi çfarë shkolle ka që mund të jetë me statusin e nëpunësit civil?

Pandeli Majko - ... të hedhë rrënjë atje për nja 10 vjet.

Fatmir Xhafaj – Nuk është problemi aty, por ai ia sjell në majë të hundës kryetarit të gjykatës dhe do të bëjë procedura për nëpunësin civil për ftuesin e gjykatës. Në sekretari gjyqësore ka gra me nga 20-30 vjet dhe do t'i bënë nëpunëse civile. Si t'i heqësh ato kur kanë

nga 20-30 vjet punë. Pa status të jenë çfarë problemi ka? I ke thënë kancelari, ndihmësi, kryesekretari, nëpunësi i financës dhe buxhetit. Pra, këta që janë të përhershëm.

Atëherë duhet thënë në nenin 51 të këtij ligji. Dakord.

Neni 52. Formimi profesional.

Vasilika Hysi – ...në referencë duke iu referuar ligjit “Për organet e qeverisjes” në paragrafin e dytë...

Fatmir Xhafaj – Neni 53. Vlerësimi kualifikues për kancelarin e ndihmësit ligjor.

Vasilika Hysi – Po, është përputhur me rregullat e njoftimeve publike.

Fatmir Xhafaj – Neni 54. Vlerësimi i kualifikuesit të nëpunësve civilë gjyqësorë.

Vasilika Hysi – Nuk ka ndryshime.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Neni 55 është dakord. Kriteret e përgjithshme të pranimit.

Neni 56. Kriteret e veçanta për pranimin e nëpunësve civilë gjyqësorë.

Vasilika Hysi -Neni 56 është riparë bazuar dhe në sugjerimin që u tha për t’u koordinuar me ligjin “Për statusin” dhe është parë edhe nga DAP-i. Është në përputhje me rregullat e parashikuara për statusin e nëpunësit civil.

Fatmir Xhafaj – Dakord me ndryshimet.

Neni 57. Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë.

Vasilika Hysi – Edhe kjo është riparë në përputhje me ligjin e nëpunësit civil.

Fatmir Xhafaj – Saktësimet që janë bërë në harmonizim me ligjin kuadër.

Vasilika Hysi – Ndërkohë ekspertët, zoti kryetar, kanë shtuar diçka që Këshilli i Ministrave pas marrjes së mendimit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton aktet e mëtejshme nënligjore për përcaktimin e kriterëve në lidhje me kualifikimin e kandidatëve. Unë kam një pyetje. Kjo është te neni 56, paragrafi i fundit.

Fatmir Xhafaj – Ne jemi te neni 57.

Dakord.

Meqenëse janë për t’u njësuar me shërbimin civil ndoshta do një formulim për të pasur standarde të njëjta me Shërbimin Civil në Republikën e Shqipërisë. Saktësoheni këtë se ndryshe konsiderohet si një ndërhyrje e ekzekutivit. Pra, për ta harmonizuar me standardet e Shërbimit Civil.

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Është propozuar nga përfaqësuesi i GOPA-s kështu që është në rregull.

Fatmir Xhafaj - Duhet riformuluar, sepse vërtet ata të DAP-it e kanë propozuar, por e shikojnë nga këndvështrimi mekanik i tyre. Ne duhet ta shikojmë dhe nga pikëpamja e nevojës së mosndërhyrjes në sistem. Kështu që do të them për efekt të harmonizimit me standardet e Shërbimit Civil në Republikën e Shqipërisë. Për këtë logjikë është apo jo, zoti Ibrahim?

Faleminderit! Dhe për pikën 8 të nenit 56 që duhet bërë ky saktësim.

Neni 57. Dakord thamë me redaktimet.

Vasilika Hysi - Te 87-a kam një pyetje, kjo te neni 5. Ju thoni që Këshilli i Lartë Gjyqësor ndan informacionin për nëpunësit civilë të regjistruar në listë dhe Këshilli i Gjykatës ia afron kandidatit të regjistruar. Po në rast se ka më shumë se një kandidat kujt do t'ia afrojë?

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Kjo është në përputhje me ligjin "Për nëpunësin civil. Në qoftë se një nëpunës civil pezullohet për çfarëdolloj arsyeje dhe më vonë, pas një periudhe të caktuar dëshiron të kthehet te vendi i tij, por vendi tashmë është i zënë, atëherë ky nëpunës do të vendoset në një listë. Nëse hapet një vend vakant atëherë do të shikohet lista dhe personi i parë që është në listë do t'i ofrohet ky vend vakant. Kjo gjë duhet bërë, sepse këta nëpunës që janë te lista paguhën nga shteti. Në qoftë se lista nuk do të ketë më persona në listë mund të merren të tjerë. Në qoftë se nuk ka vende vakante do të bëhet shpallja për vende të reja.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Neni 57 dakord bashkë me ndryshimet.

Neni 58.

Vasilika Hysi – Te neni 58 unë kam një pyetje. Duke pasur parasysh gjendjen aktuale të stafit që punon dhe që merr automatikisht statusin e nëpunësit civil, siç është deri tani dhe faktit që vendet e tjera vakante të lira që mbeten plotësohen nga kandidatët fitues të cilët kanë kaluar provimin e Shkollës së Magjistraturës. Pyetja ime është: A krijohet një pabarazi në kualitete midis atyre që vijnë nga Shkolla e Magjistraturës dhe atyre që janë në këto pozicione për shkak të lëvizjes paralele?

Agnes Bernhard - (*Flet përkthyesja*) Kjo është parashikuar te dispozita transitorë në lidhje me pozicionet vakante, apo personat që janë tashmë në pozicionet e tyre, megjithatë parashikohet që do të bëhen dy kontrolle. I pari është kontrolli i pasurisë dhe e dyta është një

kontroll i aftësive që është një lloj testimi, njësoj si ata që do të bëjnë në Shkollën e Magjistraturës.

Fatmir Xhafaj – Kur të shkojmë te dispozitat transitorë nëse kemi efekte të kësaj natyre do ta shohim.

Dakord.

Neni 59. Emërimi i kancelarëve...

Vasilika Hysi - Është në rregull.

Fatmir Xhafaj -Neni 60. Emërimi i nëpunësve civilë gjyqësorë.

Vasilika Hysi - Është në rregull.

Fatmir Xhafaj -Neni 61. Emërimi paraprak.

Vasilika Hysi - Është në rregull.

Fatmir Xhafaj -Neni 62. Periudha e provës.

Vasilika Hysi - Është në rregull.

Fatmir Xhafaj -Neni 63. Dosja dhe regjistri qendror i personelit.

Vasilika Hysi - Është rregulluar. Duke pasur parasysh sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe faktit që ka një regjistër qendror, në këtë kuadër, paragrafi i dytë i këtij ligji lexohet: “kancelari i çdo gjykate reflekton në regjistrin qendror të personelit të krijuar dhe administruar nga DAP-i, sipas parashikimeve të ligjit të nëpunësit civil dhe akteve nënligjore në zbatim të tij të dhënave profesionale për çdo nëpunës civil gjyqësor dhe punonjësit e administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me Shërbimin Gjyqësor, ose marrëdhëniet e punës, si dhe informacionin për strukturën dhe organikën e gjykatës përkatëse”.

Gjithashtu paragrafi 3 është riformuluar: “Departamenti i Administratës Publike në cilësinë e administratorit të regjistrin qendror të personelit është i detyruar t’i sigurojë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe gjykatave aksesin e nevojshëm mbi të dhënave e gjykatave në këtë regjistër”.

Paragrafi 4 është riformuluar: “Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton me vendim rregulla të hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit sipas pikës 1 të këtij neni të dhënave që mbahen në to, si dhe mënyrën e mbajtjes, hedhjes, përditësimeve të përdorimit të të dhënave”.

Fatmir Xhafaj – Dakord jeni me këto bërë me konsultimin e DAP-it? Kjo për ta njësuar. Dakord. Faleminderit!

Neni 64. Të drejtat e tyre dhe nëpunësi civil gjyqësor. Jeni dakord?

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, dua të shihnit këtë pjesën e pagesës. Në pikën 5 thuhet që kancelari kandidat merr një shpërblim baras me 50% të pagës fillestare si kancelar gjatë kursit të formimit fillestar dhe përfiton pagë të barabartë me pagën e gjyqtarëve të asaj gjykate, në qoftë se gjykata ka më shumë se 50 punonjës, ose kur ka më pak 80%. Pagat e reja të gjyqtarëve i kemi lidhur me procesin e vlerësimit. Ky ligj do të hyjë në fuqi, ndërkohë që pagat nuk do të hyjnë në të njëjtën ditë me hyrjen e ligjit në fuqi. Cila do të jetë paga e kancelarëve nga momenti i hyrjes në fuqi të ligjit?

Fatmir Xhafaj – Ato përfitimet që ka shtesa do t'i përfitojë... Është me pagën bazë duhet thënë, se gjyqtari do të ketë shumë përfitime. Pse e marrim me gjyqtarin dhe nuk e marrim me ekuivalentin e sistemit që kanë? A është nëpunës civil ky? Siç trajtohet sekretari i Përgjithshëm, drejtori i Përgjithshëm, drejtor, çfarë rangu është klasa që është atje dhe të jetë...

Kjo të verifikohet me DAP-in. Këtë pikë ta lëmë të diskutueshme.

Neni 64. Dakord me ndryshimet.

Neni 65. Vlerësimi i veprimtarisë. Dakord.

Neni 66. Transferimi i nëpunësve civilë gjyqësorë. Dakord.

Neni 67. Pezullimi nga shërbimi civil. Dakord.

Neni 68. Efektet e pezullimit. Dakord.

Neni 69. Përgjegjësia...

Vasilika Hysi – Unë kam një pyetje për efektet e pezullimit. Këtu thuhet që nëpunësi civil përfiton pagë të plotë kur pezullohet në rast procedimi disiplinor. Në rastet kur pezullimi është vendosur si masë parandaluese nga gjykata, në rast se personi është në hetim penal, personi do të marrë pagë? Ju thoni më pas që nëpunësi civil kthen 50% të pagës së përfituar gjatë periudhës së pezullimit, bazuar në një procedurë të papërfunduar disiplinore ose penale. Unë nuk arrij ta kuptoj këtë formulim.

Fatmir Xhafaj – Ata që e kanë bërë shqip jo ata që e kanë bërë anglisht.

Agnes Bernhard - (*Flet për kthyesja*) Sipas Komisionit të Venecias, për sa kohë një person është në procedim disiplinor, ai do të marrë pagën e plotë 100%. Megjithatë në qoftë se më vonë gjykata do të dalë me një vendim që mund ta shpallë fajtor, apo ai do të pushohet nga

puna, atëherë do të detyrohet që të kthejë 50% të shumës që ka marrë gjatë periudhës që ai ishte në procedim disiplinor.

Fatmir Xhafaj – Si e bëjmë me sistemin e shërbimit civil? Është i njëjti standard?

Agnes Bernhard - (*Flet për kthyesja*) Shërbimi civil që në fillim, sapo fillon procedimin disiplinor...

Fatmir Xhafaj – Në qoftë se në ligjin tonë për shërbimin civil është kështu, do të rri kështu. Në qoftë se nuk është në ligjin tonë “Për shërbimin civil” nuk do të rrijë. Do ta shikojmë nëse është te shërbimi civil do të jetë i njëjti standard. Nuk do të bëjmë shpikje këtu se e shkruajmë më bukur ne. Në qoftë se është i njëjti standard në shërbimin civil do të jetë i njëjti standard dhe këtu. A kemi thënë shërbim civil? Shërbimi civil në territorin e Republikës së Shqipërisë është me një standard. Po nuk është atje nuk është edhe këtu. Ose do ta marrim këtë këtu do të themi ta bëjnë edhe ata atje. Kur ta bëjnë ata do të bëhet dhe këtu nëpunësi i shërbimit civil. Nuk mund të bëjmë dy standarde. Ai ligj i shërbimit civil është ligji kuadër që rregullon shërbimin dhe ai ligj është i certifikuar nga BE-ja. Do të bëhet ashtu siç është. Janë të gjitha standarde të pranuar ndërkombëtare.

Neni 69. Përgjegjësia disiplinore. Dakord.

Pra te neni 68 e lamë që ta harmonizojmë si të jetë në ligjin e shërbimit civil.

Dakord.

Neni 70. Afatet e parashkrimit. Dakord.

Neni 71. Afatet për fillimin e hetimit. Dakord.

Neni 72. Fillimi i hetimit disiplinor. Dakord.

Neni 73. Të drejtat e nëpunësit civil gjatë hetimit disiplinor. Dakord.

Neni 74. Procedurat disiplinore. Dakord.

Neni 75. Kriteret për caktimin e masave disiplinore. Dakord.

Neni 76. Pezullimi i hetimeve dhe procedimit të procedurës disiplinore.

Neni 77. Pezullimi nga detyra gjatë hetimit ose procedimit disiplinor. Dakord.

Neni 78. E drejta për ankim. Dakord.

Neni 79. Regjistrimet disiplinore. Dakord.

Neni 80. Ndërprerja e marrëdhënies në Shërbimin Civil Gjyqësor. Dakord me ndryshimin te paragrafi i parë.

Neni 81. Regjistrimi në regjistrin qendror të personelit. Dakord.

Neni 82. Rregulla të hollësishme për ndërprerjen e marrëdhënieve të Shërbimit Civil Gjyqësor. Dakord.

Neni 83. Statusi i kancelarëve në detyrë.

Ne kemi rënë dakord te ligji i prokurorisë dhe për të gjitha këto që do të vendosim një standard, që ata nuk e marrin automatikisht. Mbasi të formohet këshilli, të caktojë rregullat, të caktojë dhe kriteret e vendit të punës do të testohen për pasurinë, për figurën, dhe nëse i plotësojnë kriteret e reja. Në qoftë se nuk i plotëson kriteret e reja nuk mund të rrijë. Pra, duhet të ketë 6 muaj nga formimi i këshillit. Kështu kemi rënë dakord, të njëjtin standard do të mbajnë. Nuk ka kalim automatik se nuk janë gjyqtarë ata. Ne themi gjyqtarët do të bëjnë testin dhe nuk mund të qëndrojnë në detyrë. Qëndroka në detyrë kancelari automatikisht. Sepse kemi harruar sot që shumë sëmundje që ka sistemi sot i ka nga shërbimi dhe po i japim statusin e nëpunësit civil automatikisht një njeriu që sot mund të ketë qenë aksident atje. Kështu që do të lëmë një periudhë kalimtare, do t'i nënshtrohet testit, të gjitha testeve të tjera, përfshirë dhe kriteret që ka vendi i punës. Sepse ai është sot, nuk është marrë me këtë kriter, nesër del një kriter i ri. Këshilli i Lartë Gjyqësor do të nxjerrë rregulla për këtë gjë. Ta replikojmë këtë gjë tek të gjitha që të mos kemi...

Neni 83 dakord me këtë shtesë që thamë? Kjo dhe në të gjitha nenet që vijnë në vijim që të mos...

Vasilika, thamë që është e njëjta gjë, e njëjta logjikë. Ndiqe diskutimin. Pra, është e njëjta logjikë në të gjitha.

Dakord.

Neni 85. Statusi i punonjësve të tjerë në detyrë. Dakord.

Ja ku është. Është shumë mirë. “4 muaj këshilli gjyqësor i dëgjon dhe pastaj vendos”. E njëjta gjë duhet replikuar. Jam dakord 4 muaj për të gjitha, siç e keni këtu. Ne po themi që gjyqtarit po i bëjmë vlerësimin. Po e kalojmë në skaner dhe i them dil jashtë nga sistemi në qoftë se nuk plotëson standardet. Këtij i themi që ti hyn automatikisht këtu. Po të zuri ligji aty në atë vend do të bëjë testimin. Dhe ai është pjesë e këtij fenomeni negativ që ka sot sistemi.

Dakord me ndryshimet, neni 85.

Neni 86.

Vasilika Hysi – Neni 86 është përafuar me parashikimet e Kushtetutës, duke shtuar fjalët që do të deklarojnë familjarët, të afërmit, të japim pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe telekomunikimeve vetjake, pasi bëhet fjalë për krijimin e gjykatave të posaçme. Është një dispozitë e veçantë për të punësuarit në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Ata që janë aktualisht.

Fatmir Xhafaj - Dakord, vetëm se duhet të replikohet kjo që thamë, që ata duhet të bëjnë një test dhe nuk do të jenë në listë pritjeje. Nëse nuk plotësojnë kriteret në sistem, në çfarë listë pritjeje do të jetë? Ai nuk plotëson kriteret e sistemit. Pse duhet të ketë listë pritjeje. Listë pritjeje do të ketë për atë që vjen mbrapa. Kjo është periudhë tranzitore. Nuk plotëson kriteret e sistemit, është me arsim të mesëm. Ne e kemi vënë, për shembull, që kancelari ose ai i dokumentacionit duhet të ketë arsim të lartë. Ti i thua: “Do të rish në listë pritjeje”. Për çfarë do të rrijë në listë pritjeje?

Kush është dakord me nenin 86 me ndryshimet që replikojnë me nenin 88 më pas?

Nenin 87. “Vazhdimi ose përfundimi i kontratës”.

Është me të njëjtën logjikë me ndryshimin që thamë.

Nenin 88. “Regjistri i personelit”.

Jemi dakord duke reflektuar ndryshimet për të gjithë këtë kapitull.

Neni 89. “Kompetencat tokësore të degëve të gjykatës”.

Ka ndonjë gjë? Nuk ka.

Dakord.

Nenin 91. “Numri i gjyqtarëve për gjykatë”.

Ju lutem, formuloheni pak të saktë! Ju që merreni me pjesën anglisht-shqip. Deri sa të merret një vendim Këshilli i Lartë Gjyqësor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Zoti kryetar, kam bërë unë një riformulim, është riformulim nga pikëpamja e teknikës, pa ndryshuar thelbin, përmbajtjen.

Fatmir Xhafaj - Për efekt të teknikës, jemi dakord.

“Aktet nënligjore”.

Vasilika Hysi - Ka shumë akte nënligjore që do të nxjerrë Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Fatmir Xhafaj - Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministri i Drejtësisë.

Vasilika Hysi - Edhe Këshilli i Ministrave. Në rast se do të citojmë nen për nen, rregulli është që duhen cituar. Duhet të themi që Këshilli i Lartë Gjyqësor në zbatim të parashikimeve të nenit me radhë, fillojnë nenet, që nga neni...

Fatmir Xhafaj – Jo një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji, por të paktën nga formimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, pra 6 muaj.

Gjithsesi, diskutojeni këtë.

Vasilika Hysi - Ka shumë akte nënligjore nga neni 19, paragrafi 4 dhe në vijim.

Fatmir Xhafaj – Neni 92. “Hyrja në fuqi”.

Paragrafi i dytë, çfarë është?

Vasilika Hysi - Te hyrja në fuqi, paragrafi i dytë nuk e ka vendin aty, por duhet të shkojë më lart, te neni tjetër. Duhet të zgjidhim një problem, që po e diskutojmë. Ligji “Për Gjykatën e Lartë” shfuqizohet me këtë ligj. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji duhet paralel të çojmë në seancë dhe shfuqizimin e ligjit “Për Gjykatën e Lartë”. Me të drejtë kemi diskutuar gjerë e gjatë se çfarë do të bëhet në periudhën që nuk është krijuar ende Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Fatmir Xhafaj - Kemi thënë deri në miratimin...

Vasilika Hysi - Po, është bërë një riformulim, meqenëse shfuqizohet ligji “Për Gjykatën e Lartë”, shfuqizohet ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Po aktet nënligjore të atij ligji, do të shfuqizohen, sepse ikën ligji bazë. Si do të veprohet?

Fatmir Xhafaj – Do ta lidhim me momentin e kthimit të Këshillit, shfuqizimin...

Vasilika Hysi – Ndërkohë si do të veprojë Këshilli i Lartë Gjyqësor, nëse shfuqizohet çdo gjë? Duhet të lëmë periudha tranzitore. Nuk duhet të krijojmë vakum ligjor.

Fatmir Xhafaj – Nuk bien aktet nënligjore, për sa kohë...

Vasilika Hysi - Po, pra, a mund ta parashikojë se për aq kohë që nuk bien ndesh me frymën e këtij ligji, do të veprojë Këshilli i Lartë i Drejtësisë? Ky i fundit sot ka kompetenca të tjera nga ky.

Fatmir Xhafaj - Kur të vijë, do të bëjë edhe aktet nënligjore.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, duhet të rregullohet këtu.

Çfarë do të bëjë Këshilli i Lartë i Drejtësisë deri sa të krijohet Këshilli i Lartë Gjyqësor? A do t'i marrë të gjitha kompetencat e këtij ligji?

Fatmir Xhafaj – Sigurisht që jo, është e qartë ajo. Çfarë kompetencash do të marrë? Kjo është periudhë tranzitore. Ai nuk mund të bëjë lëvizje në detyrë gjatë kësaj periudhe.

Agnes Bernhard - (*Flet për kthyesja*) Propozimi ynë është që të gjitha aktet nënligjore të ligjit të mëparshëm të shfuqizohen. Të zbatohet ky ligj duke pasur parasysh frymën dhe shkronjën e ligjit ekzistues. Pra, të zbatohet ky ligj. Përndryshe organet ekzistuese do të vazhdojnë të zbatojnë ligjin e vjetër edhe pse nuk është më në fuqi.

Në paragrafin e fundit të nenit 92 është pika 2 që thatë për ta zhvendosur lart. Po e lexoj këtë pikë: “Deri në kthimin e Këshillit të Gjykatës, funksionet e kryetarit, të kancelarit, të ministrit të Drejtësisë në lidhje me administratën gjyqësore përcaktohen nga dispozitat ligjore në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Kompetencat që tani kryhen nga disa institucione, do të vazhdojnë të kryhen nga institucionet e reja, por bazuar në ligjin e ri, në dispozitat e reja. Përndryshe organet që ekzistojnë do të vazhdojnë të zbatojnë ligjet e vjetra dhe nuk do të ketë efekt.

Fatmir Xhafaj - Nga mënyra sesi është formuluar është krejt e ndryshme nga ajo që thatë ju, sepse koncepti që i keni dhënë ju, kësaj dispozite tranzitore është që në lidhje me administrimin funksionet përcaktohen nga dispozitat ligjore në fuqi përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji. Pra, me ato që janë dhe jo me ato që do të jenë. Është e kundërta kjo që keni shkruar këtu. Ndoshta duhet ta rishikoni, sepse qëllimi që keni nuk përputhet.

E dyta, në këtë periudhë tranzitore është e vërtetë që këto nuk bëjnë emërime thelbësore, ngritje në karrierë e të tjera, sepse do të vijë Këshilli për gjashtë muaj.

Pra, në këtë periudhë të shkurtër tranzitore Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk mund t'i ketë kompetencat thelbësore, që kanë të bëjnë me promovimin, me vlerësimin. Mund të krijohen situata të papritura që e ka të vështirë t'i menaxhojë Këshilli i Lartë i ri Gjyqësor. Duhet të riformulohet kjo dispozitë. Dakord, zoti Ibrahim? Faleminderit, për mirëkuptimin!

E mbyllim këtu këtë diskutim. Besoj se jemi dakord edhe në tërësi. Po, dakord!

Miratohet edhe në tërësi me reflektimet që thamë, të cilat do t'i ndjekë relatorja së bashku me ekspertët për t'i qartësuar.

Faleminderit!

Nesër në orën 10:00 kemi ligjin “Për statusin e nëpunësit”.

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga stafi teknik i angazhuar pranë Komisionit të Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë